



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1549/1 Prot.

Tiranë, më 29.12.2022

V E N D I M

Nr. 237, datë 29.12.2022

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 189, datë 05.12.2022, të paraqitur nga znj. E.S kundër znj. L.N, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shoqërore”¹, “gjendjes familjare”², “gjendjes martesore”³, “gjendjes civile”⁴ dhe “aftësisë së kufizuar”⁵.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁶,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja E.S parashtron se, prej 5 vitesh i ka kërkuar në vijimësi znj. L.N, që t’i gjendet punësim dhe strehim, por problematikave të saj nuk i është dhënë zgjidhje dhe se nuk ka marrë asnjëherë përgjigje për kërkesat e saj.

Ankuesja ndihet e diskriminuar për shkak se është e divorcuar, ka një djalë me aftësi të kufizuara dhe është në gjendje të rënduar ekonomike, pasi jeton me të ardhurat nga pagesa e invaliditetit të djalit D.S.

Ankuesja sqaron se nuk ka aplikuar në ndonjë nga programet e strehimit, ndërsa ka kërkuar pranë Zyrës së Punës që t’i gjendet vend pune, por nuk i është gjetur një vend pune.

Përfundimisht ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit për shkaqet e sipërcituara.

¹ Ankuesja i referohet gjendjes si e divorcuar.

² Ankuesja i referohet gjendjes si e divorcuar.

³ Ankuesja i referohet gjendjes si e divorcuar.

⁴ Ankuesja i referohet gjendjes si e divorcuar.

⁵ Ankuesja i referohet aftësisë së kufizuar të djalit të saj D.S.

⁶ Në vijim do t’i referohemi me shkurtësën Komisioneri.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, (LMD) përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike**, arsimore ose **shoqërore**, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, **gjendjen familjare ose martesore**, **gjendjen civile**, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, **aftësinë e kufizuar**, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga LMD, në nenin 3, pika 1, ku parashikohet: “1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesja pranë Komisionerit, konstatohet se:

Ankuesja E.S pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara prej saj pasi nuk i është gjetur një vend pune dhe një strehim. Ankuesja e drejton ankesën e saj kundër znj. L.N, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke pretenduar kështu se ky është subjekti i cili me veprimet ose mosveprimet e tij e ka diskriminuar ankuesen për shkaqet e pretenduara prej saj, duke mos i siguruar punësim dhe një strehim. Duke mbajtur në konsideratë pretendimet për diskriminim të ankueses, Komisioneri vlerëson se ato gjejnë rregullim nga ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” dhe ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”.

Ndërsa ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit, të programeve aktive e pasive të tregut të punës, si dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre, ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim

krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim si dhe institucionet përgjegjëse.

Në bazë të ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, janë Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Punësimit, institucionet të cilat në bazë të procedurave përkatëse, ofrojnë shërbime punësimi.

Në bazë të ligjit nr. 22/2018 *“Për strehimin social”*, janë njësitë e vetëqeverisjes vendore, autoritetet përgjegjëse që në bazë të procedurave të përcaktuara ligjore, mundësojnë strehimin e personave që janë të pastrehë.

Znj. L.N, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa dhe pretendohet se me veprimet dhe mosveprimet e tij ka diskriminuar ankuesen, nuk ka asnjë përgjegjësi dhe kompetencë, në fushën e punësimit dhe strehimit, fusha në të cilat ankuesja pretendon se është diskriminuar.

Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që sipas rastit, do të përbënin objektin qëndror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 02.04.2008 dhe nr.19, datë 03.05.2007*).

Në këtë kuadër, znj. L.N, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nuk mund të legjitimohet si subjekt kundër të cilit mund të paraqitet ankesa për diskriminim sipas objektit të pretenduar prej ankuses.

Komisioneri rekomandon ankuesen, që në lidhje me problematikën e punësimit duhet të aplikojë sipas procedurave përkatëse pranë Zyrës Vendore të Punësimit Tiranë, ku ankuesja ka vendbanimin, ndërsa në lidhje me çështjen e strehimit të aplikojë sipas procedurave përkatëse në një nga programet e strehimit, pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin, Bashkisë Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;...”* Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet, pasi nuk plotëson kriteret e kërkuara ligjore pasi është paraqitur kundër një subjekti që nuk ka legjitimitet pasiv, dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “b” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 189 regj., datë 05.12.2022, të paraqitur nga znj. E.S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja ekonomike, Gjendja shoqërore, Gjendja familjare, Gjendja martesore, Gjendja civile, Aftësia së kufizuar.
Fusha: Punësim, Strehim
Lloji i vendimit: Mospranim